



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

Nr. 2254 Prot.

Tirane, me 20 . 03 .2018

DEKLARATE MJEDISORE

per Vleresimin Strategjik Mjedisor

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 91, date 28.02.2013 "Per vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, leshon kete Deklarate Mjedisore per:

Dokumenti strategjik: Strategjia per Sektorin e Energjise 2018-2030

Kerkuesi: Ministria Infrastruktures dhe Energjise

Kufijte e zones qe mbulon plani: Republika e Shqiperise

Perdorimi i deklarates mjedisore

Deklerata Mjedisore nuk perjashton detyrimin qe per projekte te vecanta te parashikuara ne kete Plan t'i nenshtrohen kerkesave te legjislacionit ne fuqi per vleresimin e ndikimit ne mjedis, per lejet e mjedisit dhe akteve te tjera normative ne fuqi.

Qendrimi i Ministrise:

Strategjia per Sektorin e Energjise 2018-2030 e propozuar ne parim perputhet me objektivat e mbrojtjes se mjedisit dhe zhvillimit te qendrueshem.

Strategjia e Energjise per Shqiperine 2018-2030 eshte dokumenti kryesor strategjik per sektorin energjetik te vendit. Ajo eshte ne perputhje me perpjekjet kombetare per te mbeshtetur zhvillimin ekonomik dhe per te permbushur angazhimet per Komunitetin e Energjise, integrimin ne BE dhe marreveshjet e tjera nderkombetare, duke rritur sigurine e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto te perballueshme per qytetaret shqiptare dhe te gjithe sektoret e ekonomise.

Parimet qe udheheqin zhvillimin e kesaj strategjie jane:

- Rritja e sigurisë së furnizimit me energji ndërsa sigurohet zhvillim i qëndrueshëm dhe sigurim i kostove të përballueshme të energjisë për qytetarët shqiptarë dhe të gjithë sektorët ekonomikë;
- Diversifikimi i mëtejshëm i burimeve të furnizimit dhe nderlidhja me rrjetet rajonale dhe evropiane të energjisë elektrike dhe gazit natyror;
- Krijimi i një tregu konkurrues dhe të organizuar që ofron sinjale korrekte për prodhimin dhe konsumin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, duke marrë parasysh ndikimin specifik të ndryshimeve klimatike në prodhimin e brendshëm të energjisë;
- Integrimi i tregut të energjisë elektrike në përputhje me të ashtuquajturin procesi i Berlinit.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapësirë dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha objektivat janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përfshirja efektive e grupeve përkatëse të interesit ka kontribuar në cilësinë e vlerësimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve përkatëse.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit

Gjatë zbatimit të Strategjisë për Sektorin e Energjisë 2018-2030, priten të ndohin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike, si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që teknologjitë për prodhimin e energjisë dhe shpërndarjen e saj do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe me tej, gjë që do të sjellë si pasojë përmirësim të cilësisë së ajrit dhe cilësisë së shëndetit human, midis të tjerave. Për më tej në pjesën pozitive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastrukurës bashkëkohore.

Zbatimi i kësaj Strategjie të Energjisë do të rrisë sigurinë e furnizimit të energjisë në Shqipëri dhe do të fillojë të integrojë tregun shqiptar të energjisë në tregjet rajonale dhe evropiane. Kjo strategji bazohet në një skenar optimal të energjisë që balancon interesat kombëtare me ato të nënsektoreve të ndryshme të energjisë. Përveç kësaj, strategjia është projektuar për të krijuar kushte të barabarta për të gjitha kompanitë e energjisë të angazhuara në tregun shqiptar të energjisë dhe për të minimizuar ndikimet negative në mjedis.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastrukurës në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka vecori të theksuara të ndryshme dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastrukurës, sidomos atyre me shtrirje të gjera dhe korridoreve sipas sektoreve (energji, transport, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgimie kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor

mbi masat zbutese dhe nje zbatim te pershtatshem te ketyre masave. Impakte negative mbi shendetin human mund te ndodhin per shkak te rritjes se ndotjes nga zhurmat dhe impaktet ne cilesine e ujrave apo ajrit.

Bazuar ne rezultatet metrike strategjike, analiza e detajuar tregon se skenari me i dobishem i zhvillimit per sektorin energjetik shqiptar, do te ishte zbatimi i te gjitha masave nga skenaret Efiçienca e Energjise (EE), Energjise se Ripërteritshme (RES) dhe integrimin e tregjeve te energjise elektrike Shqiperi-Kosove, se bashku me komponentet e Promovimit te Gazit Natyror dhe shfrytezimit te tij ne sektoret e prodhimit te energjise elektrike dhe industrise, duke shtyre per nje periudhe afatgjate investimet e infrastruktures se gazit qe kerkohen per t'i sherbyer klienteve rezidenciale dhe komerciale.

Skenari i rekomanduar i zhvillimit konsiderohet me i dobishem sepse ka potencial per te arritur rezultatet e meposhtme:

- Potencialin per te reduktuar importet e energjise me 32% krahasuar me skenarin baze;
- Potencialin per te arritur ruajtjen e objektivit te Burimet e Ripërteritshme te Energjise (BRE) pas 2020, si dhe duke perfshire investimin e infrastruktures se gazit natyror per t'i sherbyer sektoreve te energjise elektrike dhe industrise per periudhe afatmesme dhe afatgjateper klientet rezidenciale dhe komerciale;
- Potencialin per te reduktuar kerkesen perfundimtare te energjise per 19,4%, ne krahasim me skenarin baze;
- Potencialin per te reduktuar emetimet e gazeve me efekt sere (GHG) me 28% ne krahasim me skenarin baze;
- Potencialin per te reduktuar kerkesat per gjenerimin e energjise elektrike nga te pakten 31%;
- Potencialin qe gazi natyror te penetroje deri ne 19,81% te burimeve primare totale te energjise deri ne vitin 2030; dhe
- Potencialin per te reduktuar Intensitetin e Energjise se Prodhimit te Brendshem Bruto (PBB) me 18%.

Vleresimi i perputhshmerise se objektive:

Gjate shfrytezimit, ne disa raste objektivat specifike jane vetem pjeserisht te pajtueshme me ato mjedisore per shkak te ndikimeve negative ne mjedisin biofizik (perdorimi i tokes, etj.). Ndersa pajtuesmeria vjen per shkak te ndikimeve pozitive mbi ndryshimet klimatike e ceshtjet sociale (punesim, rritje e nivelit te jeteses, etj.).

Ne thelb te dyja objektivat specifike te strategjise, qofte ajo qe synon vendosjen e nje sistemi objektiv prioritizimi, qofte objektiva qe synon hartimin e nje plani te fazuar te investimeve, nuk kane lidhje direkte me objektivat e VSM, megjithese, indirekt arritja e objektiveve te strategjise ndikon pozitivisht dhe perben nje baze te shendoshe per zbatimin e suksesshem te strategjise dhe ne nje menyre miqesore me mjedisin. E pare ne kete kendveshtrim, mund te

deklarohet perputhshmeri e plote mes objektivave specifike te strategjise dhe objektivave mjedisore te VSM.

Objektivat strategjike afatgjate ne vijim jane identifikuar per te realizuar angazhimet aktuale qe jane ndermarre nga Qeveria Shqiptare:

- Permiresimi i besueshmerise dhe sigurise se furnizimit me energji;
- Zhvillimi i burimeve te brendshme te energjise ne nje menyre te qendrueshme dhe konkurruese;
- Permiresimi i efektivitetit te kostove te sistemeve te furnizimit me energji;
- Arritja e objektivave per burimet e riparterishme te energjise dhe eficiencen e energjise te percaktuara ne Planin e dyte Kombetar te Veprimit per Eficiencen e Energjise dhe Planin Kombetar te Veprimit per Energji te Riparteritshme;
- Zhvillimi i politikave me kosto me te ulet dhe te qendrueshme per ngrohje dhe ftohje te ndertesave te banimit;
- Integrimi i tregut shqiptar te energjise dhe gazit natyror me tregjet rajonale te Komunitetit te Energjise dhe evropiane; dhe
- Arritja e objektivave te Kontributit Kombetar te Percaktuar (KKP-NDC) per reduktimin e emetimeve te gazeve me efekt sere (GHG).

Ne kuader te analizes mjedisore te perputhshmerise mes dy dokumenteve, eshte analizuar perputhshmeria e objektivave mjedisore te VSM me keto objektiva/drejtime prioritare, te listuara si me poshte:

- Reduktimin e importeve te energjise dhe rritjen e prodhimit vendas te energjise nepermjet plotesimit te kerkeses se ardhshme per energji ne nje menyre te qendrueshme duke rritur nderkohe mireqenien sociale.
- Permiresimin e Eficiences se energjise ne sektoret residencial, sherbime, transport, bujqesi dhe industri.
- Rritjen e perdorimit te teknologjive te BRE, bazuar ne planifikimin me kosto minimale, qendrueshmerine, ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Penetrimin e gazit natyror ne sektorin energjetik shqiptar permes investimeve kyçe ne infrastrukture.
- Zhvillimin e mekanizmave per nxitjen e investimeve te huaja direkte ne sektorin energjetik te Shqiperise.
- Rritjen e konkurrences ne tregun e energjise duke ruajtur interesat e konsumatoreve dhe investitoreve;
- Permiresimin e harmonizimit dhe integritit te politikës dhe rregullimit te sektorit shqiptar te energjise me acquis-in e Komunitetit te Energjise per energjine dhe tregjet e energjise rajonale dhe te BE-se.

- Zhvillimin e nje kuadri politik per energjine (duke perfshire eficiencen energjetike) ne transport bazuar ne Strategjine e Sektorit te Transportit ne Shqiperi - Strategjia dhe Plani Final i Veprimit sipas VKM Nr.811, date 16.11.2016, dhe futja e teknologjive te reja ne te gjitha sektoret e tjere.
- Zhvillimi i nje tregu konkurrues qe ofron sinjale korrekte per prodhimin dhe konsumin e energjise elektrike dhe gazit.
- Aktivitete te fokusuara ne lidhje me perdorimin, rehabilitimin dhe permiresimin e infrastruktures ekzistuese energjetike jo eficiente qe ndikon negativisht ne mjedis dhe ne zonat potencialisht me vlere te larte per sektore te tjere te zhvillimit, si psh.turizem, bujqesi etj.

Ne kendveshtrimin e perputhshmerise me objektivat mjedisore, objektivat/drejtimet prioritare te Strategjise qendrojne si me poshte:

- shtate (7) drejtime prioritar perputhen plotesisht me objektivat mjedisore;
- tre (3) drejtime prioritare kane perputhshmeri te pjesshme te larte me objektivat mjedisore;

Pra ne pergjithesi te gjitha drejtimet prioritare te strategjise kombetare ne sektorin e energjise jane ne perputhje me objektivat mjedisore te VSM.

Detajimi i masave per mbrojtjen e mjedisit:

Me qellimin per te shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative ne mjedis te strategjise ne te gjitha fazat e tij duhet te zbatohen me perpikmeri te gjitha masat e meposhtme.


- Te hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjate zbatimit te strategjise, me synim mbledhjen e te dhenave per ndikimet konkrete dhe pasojat ne mjedis gjate zbatimit te tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutese shtese, qe duhet te zbatohen per te garantuar mbrojtjen e mjedisit. Programi i Monitorimit Mjedisor plan te hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklarates Mjedisore dhe te merret miratimi i autoriteve pergjegjese per mbrojtjen e mjedisit.
- Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, qe zbaton dhe mbikqyr zbatimin e strategjise te hartoje nje raport vjetor per masat e marra per mbrojtjen e mjedisit gjate zbatimit, te cilin duhet ta dergoje prane Ministrise se Mjedisit jo me vone se java e fundit e muajit nentor.
- Me qellim lehtesimin e realizimit te programit te monitorimit mjedisor te strategjise mund te perdoren programe ekzistuese monitorimi, qe perputhen me qellimin e programit te monitorimit mjedisor te planit.
- Projektimi i objekteve te bazohet ne parimin e teknologjise me te mire te disponueshme, e cila eshte efciente ne perdorimin e energjise, si perdorimi i teknologjive izotermike te ndertimit per cdo objekt te ri po keshtu edhe ato te minimizimit te perdorimit te ujit.

- Politikat dhe aktivitetet infrastrukture te parashikuara ne strategji te sigurojne kohezion, efikasitet dhe qendrueshmeri dhe rritjen e perfitimeve per perdoruesit e kesaj infrastrukture.
- Te mbrohen vlerat natyrore te zonave ne te cilat shtrihet studimi dhe te shmangen ne maksimum demtimi i siperfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike ne kuader te zbatimit te strategjise duhet te projektohen ne harmoni me kuadrin ligjor per mbrojtjen e natyres, duke respektuar shkallen e mbrojtjes se zones apo nenzones se mbrojtur ku do te nderhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve qe gjenden ne zone, si dhe te komunikohet/bashkepunohet me AKZM per te marre masat e domosdoshme per mos cenimin e statusit te ketyre zonave.
- Gjate fazes se projektimit dhe sidomos perpara nisjes se fazes se zbatimit te projekteve/aktiviteteve specifike individuale ne kuader te zbatimit te strategjise duhet te perfshihen masa qe do te lehtesojne ruajtjen e korridoreve te kafsheve migratore. Ne rastin kur projektet qe do zbatohen mund te prekin zona te Mbrojtura apo mund te ndodhen ne afersi te tyre.
- Te zbatohen masa zbutese per zhvillimin e infrastruktures, gjate rehabilitimit/ndertimit duhet te parashikojne edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Ne asnje rast nuk duhet te projektohet brenda, por as ne afersi te territorit te zonave te mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet ne ajer dhe zhurmat ndikojne ekosistemet dhe habitatet e llojeve nen mbrojtje. Promovimi brenda dhe ne periferite e zonave te mbrojtura duhet te jete ngritja e infrastrukturave te lehta qe mbeshtesin aktivitetet pa makina, ne drejtim te sporteve dhe aktiviteteve ne natyre.
- Hartimi i planeve te energjise, krahas prioritizimit te zonave te gjelberta publike, duhet te paraprijne planet urbane te zhvillimit dhe te kene objektiva te matshme per cilesine e ajrit.
- Te merren masa per mbrojtjen dhe mos demtimin e burimeve ujore qe gjenden ne zonen ne studim.
- Strategjia duhet te jete me konservatore ne raport me ceshtjet e menaxhimit dhe cilesise se ujerave si sasi dhe cilesi, perfshire dhe akuiferet. Projektet ne kuader te zbatimit te strategjise qe do te kene te bejne me perdorimin e ujit te konsiderohen me kondicione kufizuese mjedisore, per aq kohe sa pasigurite dhe ireversibiliteti eshte i larte.
- Elementi i ndikimit te mbetjeve te parashikuara kerkon te trajtohet qysh heret ne zhvillimin e masave, ne menyre integrale, ndersektoriale dhe ne lidhje me menaxhimin e tokes. Keto sisteme duhet te perfshijne 3R-te (Riciklimi, Riperdorimi, Reduktimi), si pjese e suksesshme e zbatimit ne praktike.
- Ne kuader te planifikimit te menaxhimit, vemendje e vecante te kushtohet per integrimin e zonave te sigurise nga permbytjet dhe atyre ligatinore, nderkohe qe masat e pylezimit te synojne stabilizimin e humbjeve e tokes nga permbytjet (te zbatohet duke perdorur lloje te bimesise autoktone qe i rezistojne edhe permbytjeve).
- Para fillimit te zbatimit te projekteve ne kuader te zbatimit te strategjise te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.

- Te planifikohen dhe projektohen ne menyre strategjike elementet e administrimit te mbetjeve.
- Para fillimit te zbatimit te projekteve te zgjidhet ceshtja e administrimit te volumit inert qe do te gjenerohet nga operacionet ndertimore.
- Ne teresi, projektet specifike ne kuader te zbatimit te strategjise duhet te projektohen ne harmoni me standartet e ruajtjes se peisazhit dhe mbrojtjen e trashegimise kulturore, ku se bashku me elementet e cilesise se mjedisit te jene paresore duke aplikuar „best practices“.
- Gjate zbatimit te strategjise te vihen ne zbatim masat zbutese e propozuara ne raportin e VSM-se per minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative ne mjedis.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarsisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te strategjise eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.
- › Nese strategjia nuk eshte miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit te deklarates, atehere deklarata behet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj te varesise, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se strategjia nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin pergjegjes per zbatimin dhe miratimin e strategjise, si dhe sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershem te zbatimit deri ne sqarimin e situates.
- › Nese pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standartet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i strategjise, me qellim qe te permbushen standartet mjedisore.
- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.


MINISTER
Blendi KLOSI